



Java e vetëdijesimit pensional këtë vit u mbajt nga 7 deri më 15 shtator, ndërsa Dita e vetëdijesimit pensional si zakonisht më 15 shtator. Duke filluar nga viti 2014, Dita e vetëdijesimit pensional ka për qëllim ta theksojë rëndësinë e kursimit pensional. Në kuadër të misionit të tij për t'i mbrojtur interesat e anëtarëve të fondeve pensionale dhe për ta nxitur zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital për ditë më të sigurt pensionale, Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional – MAPAS e shënoi 15 shtatorin – Dita e vetëdijesimit pensional me një sërë aktivitete duke i shfrytëzuar mjetet elektronike të komunikimit dhe mediat sociale.

Aktivitetet edukative u organizuan me qëllim për ta ngritur vetëdijen e qytetarëve për rëndësinë e sigurimit pensional dhe për të rritur informimin për sistemin pensional. Me atë, të siguruarit dhe anëtarët aktualë dhe të ardhshëm fituan bazë të rëndësishme që të mund ta planifikojnë dhe ta sigurojnë të ardhmen e tyre pensionale. MAPAS potencon se është veçanërisht e rëndësishme që të informohen në kohë për të drejtat, obligimet dhe përfitimet e anëtarëve të fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale pas fillimit të marrëdhënie së punës.

За посигурни пензионерски денови

E - MAPAS  
nr. 43

tetor 2022



<http://MAPAS.MK>



<http://www.instagram.com/mapas.mk>



<http://www.linkedin.com/mapas.mk>



<http://www.facebook.com/MAPAS.MK>



Për më shumë informacione vizitoni ueb faqen tonë dhe adresat tona në mediat sociale.



Doli hulumtimi më i ri vjetor i OECD-së - Annual Survey of Investment Regulation of Pension Funds and Other Pension Providers. Ky hulumtim i përshkruan rregulloret kuantitative kryesore të investimit të fondeve pensionale në OECD dhe vendet e zgjedhura të cilat nuk janë anëtare të OECD-së (shumica prej tyre janë anëtare të IOPS). Ky investim i mbulon rregullat investuese për entitetet tjera pensionale (shoqëri për sigurim jetësor) për disa vende, si Danimarka, Franca, Irlanda, Koreja, Letonia dhe Suedia në mesin e vendeve anëtare të OECD-së dhe Jordani në vendet që nuk janë anëtare të OECD-së. Informacionet kanë të bëjnë me rregullat që nuk janë në fuqi në fund të vitit 2021 (ose viti i fundit në dispozicion). Raporti i mbulon të gjitha llojet e planeve pensionale. Rregulloret mund të dallohen sipas llojeve të planeve (plane profesionale/individuale/ të detyrueshme dhe vullnetare, plane me pensione të definuara (DB)/plane me kontribute të definuara (DC).

Informacionet e mbledhura kanë të bëjnë me të gjitha format e kufizimit kuantitativ të portofolit (minimum dhe maksimum) të aplikuar në fondet pensionale dhe entitetet tjera pensionale në nivele të ndryshme juridike (ligj, rregullore, udhëzim etj).

Lidhja: [Annual Survey of Investment Regulation of Pension Funds and Other Pension Providers](#)



Të gjithë dëshirojmë një ditë të pensionohemi dhe nuk mund të vazhdojmë të mbështetemi në shpresën për të fituar në lotari, tani është koha për të ndërmarrë hapa reale për të ardhmen tonë.

KUSHTONI VËMENDJE PENSIONIT TUAJ!



Kemi një detyrë të thjeshtë: ta informojmë publikun për sigurimin pensional me financim kapital dhe për të drejtat e saj në sistemin pensional.

KUSHTONI VËMENDJE PENSIONIT TUAJ!

**Keni pyetje dhe ankesa?**

**Lajmërohuni në MAPAS ose shkruani mesazh në [contact@mapas.mk](mailto:contact@mapas.mk)**



AGJENCIA E SUPERVIZIONIT TË SIGURIMIT PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL (MAPAS)

Stiv Naumov 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut,  
tel: (02) 3224 229  
<https://mapas.mk>